



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Majlinda Bedrolli	24.03.2025	04.04.2025	2025/0191
Eksperti Teknik	Data e autorizimit të ekspertit teknik		
Kreshnik Spahiu	26.03.2025		

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 21.03.2025, OE “ARITECH”- Prishtinë, ka parashtuar ankesë me nr: 2025/0191, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë GOE “STORM ICT L.L.C ; Sefabit L.L.C - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me pajisje te teknologjise informative” me nr. të prokurimit: "ZK104-25-858-5-5-8", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – ZYRA E KRYEMINISTRIT. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë Mini-tender, sipas Kontratës Publike Kornizë me nr. të Ref.UA/2016 24 3927 111, vlera e parashikuar e kontratës: 87,000.00 €. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues/teknik i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

AK gjatë realizimit të kësaj procedure ka shkelur dispozitat e LPP-së si më poshtë: Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti 1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi 1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese

dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve 1. Autoriteti kontraktues do të themelojë një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës. Me fillimin e zbatimit të prokurimit elektronik, KRPP-ja do ta nxjerrë legjislacionin detyësor lidhur me këtë çështje. Neni 61 Tenderët Jo-Normalisht të Ulët 1. Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jonormalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafit 2. të këtij neni. 4. Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe sqarimeve të dorëzuara nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues vendo

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Me datë 10.03.2025 kemi pranuar Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues. Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim që të shpërblejë me kontratë OE EGS & Pattern Shpk. Ne kemi kërkuar qasje në dokumente për GOE EGS& Pattern Shpk, që është menduar të shpërblehet me kontratë

Ne baze të analizimit të ofertes teknike të GOE EGS& Pattern Shpk kemi hasur disa mospajtime substanciale me specifikimin teknik përkatesisht çmime anormale të ofruara për këto aktivitete prokurimi. Ne vazhdim të elaborojmë me fakte të gjitha mospajtimet dhe dyshimet tona për vlerësimin e kryer dhe ofrimin e çmimit jonormalisht të ulët. Autoriteti Kontraktues për këto aktivitete prokurimi ka vendosur disa kritere apo specifikime teknike të cilat do të duhet të plotësohen nga të gjithë OE-te.

ARGUMENTI 1 Autoriteti Kontraktues tek Aneksi 1 – Specifikimet teknike përkatesisht të Pozicioni 4 ka kërkuar si në vijim:

AK në specifikim teknik ka theksuar gjeneratën e fundit të procesoreve për këto pozicione. GOE EGS & Pattern Shpk për këto pozicione ka ofertuar me modelin HP ENVY x360 me procesor si në vijim:

GOE EGS & Pattern Shpk ka ofruar Intel Core Ultra 7 processor 155H. Ky procesor nuk e plotëson kërkesën tuaj pasi që ky procesor është i gjeneratës së parafundit respektivisht gjenerata e parë e procesoreve Ultra. Ne vijim gjëni disa dëshmi rreth gjeneratës së fundit të procesoreve: Linku: <https://www.cpubenchmark.net/compare/5677vs6281/Intel-Ultra-7-155H-vs-Intel-Ultra7-258V>

Burimi nga CPU Benchmark. Linku dhe printscreen me lart e thekson shumë qartë se cila është gjenerata e fundit të procesoreve të kësaj kategorie. Për më tepër gjëni në vijim sqarimin rreth kuptimit të drejtë të gjeneratave nga Intel: Printscreen nga Weblink përkatesisht Intel:

Linku nga Intel ku shpjegon gjeneratat:

<https://www.intel.com/content/www/us/en/processors/processor-numbers.html> Po ashtu edhe nga ChatGPT mund të gjendet lehtë shpjegimi i drejtë rreth gjeneratës së procesorëve:

Nga të gjitha keto me lart është mëse e qartë që gjenerata e fundit e procesoreve Intel Core Ultra 7 është gjenerata e dytë (2) respektivisht në këtë rast është Intel core Ultra 258V (nga oferta jone), ndërsa gjenerata Intel core Ultra 7 155H (gjenerata e parë) është gjenerata e parafundit e procesoreve. Ne vazhdim të paraqesim disa fakte rreth çmimit jonormalisht të ulët për

produktin apo pozicionit 5.

ARGUMENTI 2 AK ne FPO perkatesisht tek Aneksi 1-Specifikimi teknik për pozicionin 5 ka kerkuar si ne vijim:

GOE EGS & Pattern Shpk per pozicionin 5 ka ofertuar modelin si ne vijim: ThinkStation P3 Tower, model i cili ne fakt e ploteson kerkesen per specifikim teknik, por çmimi i ofruar për këtë pozicion është i pakuptimte, çmim jonormalisht i ulet gjë qe neve na bën te dyshojmë qe kemi te bejme ne planifikim paraprak për mos dorezim apo realizim te duhur ne kuptim te dorezimit te produkteve te kerkuara! Çmimi njësi i ofruar për pozicionin 5 është 925 euro (çmim jonormalisht i ulet). Printscreen nga oferta financiare e GOE EGS & Pattern Shpk” : AK lidhur me kete produkt, sigurisht qe ka planifikuar paraprakisht buxhetin, planifikimi i tille percaktohet duke u bazuar ne çmimet e tregut për te gjitha produktet. Prandaj duam te theksojme qe AK do duhej perdorur te gjitha veprimet ligjore ne kuptim te çmimeve jonormalisht te uleta te cilat mund te ofrohen nga te gjithë OE-te. AK ka kerkuar Workstation me procesor i9-13900, perveç te tjerash me karteles Grafike NVIDIA RTX 4500 ADA 24 GB GDDR6 Ne vijim mund te shihni cmime referenciale te karteles Grafike te kerkuar nga faqja e njerit nga distributoret:

Çmimi i ofruar nga GOE EGS & Pattern shpk nuk është i mjaftueshem as per Karteles Grafike, se jo edhe për tërësinë e produktit te ofruar! Ne vijim do te paraqesim disa fakte te çmimeve referenciale për produktin e kerkuar :

Te gjitha këto argumente me lart e theksojnë shume qarte qe kemi te bëjmë me çmim jonormalisht te ulet per kete produkt te ofruar. AK ka pasur argumente te mjaftueshme për te verifikuar çmimet jonormalisht te uleta duke u bazuar ne Nenin 61 te LPP-se dhe rregullave për tenderet jonormalisht te ulet. Çmimi jonormalisht i ulet është ne kundershtim me LPP-ne, prandaj AK duhet te sigurohet qe është ne perputhje me te gjitha rregullat e prokurimit për te pasur mbarevajtje dhe ekzekutim te duhur te kontrates. Ne kemi ofruar argumente te mjaftueshme, lehte te vertetueshme nga kushdo, per te konkluduar ne perfundimin qe çmimi i ofruar për pozicionin 5 nga GOE EGS & Pattern Shpk është jonormalisht i ulet. Sidoqoftë ne kemi ofruar argumente te mjaftueshme edhe gjeneraten e fundit dhe te parafundit te procesorit për Pozicionin 4 te ofruar. Lidhur me vendimin e AK-se te dates 18.03.2025 për refuzim te kërkesës për Rishqyrtim, ne vijim do te shqyrtojme pergjigjet e tyre. AK lidhur me pozicionin 4 Brand Name laptop x 360-Model III, ne pergjigje te tyre nuk merret fare me Gjeneratën e procesorit, kerkese e cila është e evidentuar ne specifikim teknik te dosjes se AK-se. Jemi te habitur me analizen e tyre krahasuese, duke anashkaluar kërkesën e tyre rreth gjenerates se procesoreve. AK ne pergjigje te tyre merren me synimet e tyre, vlerësimi i tille është ne kundërshtim me trajtimin e barabarte te OE-ve Neni 7 paragrafi 1

Te gjitha synimet duhet te jene ne perputhje me kerkesen e cila është bazike dhe shume e qarte. Detyre e OE-ve është plotësimi i specifikave ne kete rast, plotesim te gjenerates se kerkuar. Gjenerata e fundit e procesoreve është vendosur nga vet AK, kerkesa e gjenerates se fundit është patjeter te plotesohet nga çdo OE, ndersa pranimi i gjenerates se parafundit është ne kundershtim me kerkesen ne FPO dhe ne kundershtim me LPP-ne dhe nuk mund te anashkalohet nga vete kerkuesi-AK. Krahasimi i gjeneratave te procesoreve është i pakuptimte, sepse ne fushe e teknologjise informative është njejte si te thuhet: Kerkesa te jete per procesor i7xx ndersa te thuhet qe pranohet edhe procesor i5xx sepse ky i fundit ka performance edhe ckado tjeter me te mire. Apo nese marrim shembull ndonje veture, te themi kerkesa është per Golf gjenerata 8 ndersa te thuhet qe Golf gjenerata 7 ka performance me te mire, (pasi motorri i ketij te fundi është me i fuqishem, me shume

PS!!!). Me kete qasje i humb kuptimi i vendosjes se gjenerates se procesorit si kerkese. Artitektura e procesorit te gjenerates se fundit Lunar Lake intel® Core™ Ultra 7 258V eshte shume me e avancuar sesa e gjenerates se parafundit Meteor Lake Intel® Core™ Ultra 7 155H. PERDERISA KERKESA E AK KA QENE GJENERATA E FUNDIT, ASNJE KRAHASIM TEKNIK MES GJENERATAVE NUK ESHTË ME VEND! Vlerësojmë qe AK do te duhetj vendoste per te refuzuar oferten e GOE EGS & Pattern shpk me arsyetimin ne vijim: Jeni te eliminuar pershkak te gjenerates se procesorit pershkak se është kërkuar gjenerata e fundit ndersa ju keni ofertuar me gjeneraten e parafundit.

Përgjigja nga AK tenton te thotë qe AK mund te shkruaj çfarëdo kerkese për gjeneraten e procesorit, pastaj ate ta zhvlereson kur te dëshiron, te lëshohet ne krahasime te panevojshme, dhe te mos merret fare me kerkemat qe ka vendosur vet. Ndërsa lidhur me pergjigjen për pozicionin 5 për çmim jonormalisht te ulet AK nuk ka marr parasysh fare argumentet tona për çmim jonormalisht te ulet. AK thekson qe OE fitues ka dhënë dëshmi te mjaftueshme se do ta permbushe kontraten ne tërësinë e saj. Ne AK-se i kemi ofruar argumente te mjaftueshme për te korigjuar vendimin e tyre, por siç duket edhe ne këtë rast si ne rastin e gjenerates se procesorit nuk ka shprehur gatishmerine per te marr parasysh argumentet tona. Ashtu siç kemi theksuar me lart, çmimi 925 euro nuk mjafton te blihet as kartela Grafike NVIDIA RTX 4500 ADA 24 GB GDDR6 qe eshte pjese e ketij specifikimi teknik. Vleresojme qe me nje kerkim te thjesht mund te vertetohet lehte çmimi jonormalisht i ulet per pozicionin 5. Ne vijim po renditim çmimin njesi te te gjithë OE-ve per pozicionin nr. 5: 1) GOE Storm ICT LLC; Safabit LLC- çmimi njesi 4039.95 euro 2) Interadria LLC çmimi njesi 4099 euro 3) ZZ ICT Solutions LLC;PC Comp shpk- çmimi njesi 4698 euro 4) Aritech SHpk, çmimi njesi 4473 euro 5) Infinit Shpk, çmimi njesi 3978 euro 6) GOE EGS; Pattern Shpk çmimi njesi 925 euro Nga kjo qe shihet me lart, te gjitha çmimet e te gjithë OE-ve kane çmime perafersisht te njejta perveç GOE EGS;Pattern Shpk eshte shume e qarte qe ketu kemi te bejme me çmim jonormalisht te ulet. Ketu kemi te bejme ose me çmim jonormalisht te ulet ose është menduar te dorëzohet produkt qe nuk e plotëson specifikimin teknik per pozicionin nr.5 ose ky pozicion te mos dorëzohet fare me çfarëdo arsyeimi. Nëse marrim te gjitha çmimet se bashku dhe perpjetojme me 6 ofertat na del çmimi mesatar 3702.16 euro. Çmimi 925 euro katerfishi me lire sesa çmimi mesatar se te gjithë OE te tjerë. Kërkojmë nga Organi shqyrtues i prokurimit qe te vendos si ne vijim:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar Ankesa e OE “ARITECH SHPK” lidhur me tenderin “Furnizim me pajisje të teknologjisë informative” me nr. prokurimi ZK104-25-858-5-5-8

ANULOHEM Njoftimi mbi vendimin e AK-se, nga “ZYRA E KRYEMINISTRIT , te kërkohet qe tenderi të Rikthehet ne Rivlerësim. Vlerësimi te behet ne baze te kërkesave ne dosje te tenderit, Rregullores se prokurimit publik dhe LPP-se.

KRITERET PËR VLERËSIM

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "ARITECH", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje të teknologjisë informative" me numër të prokurimit: "ZK104-25-858-5-5-8, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – ZYRA E KRYEMINISTRIT

 Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo Qeveria -Vlada-Government Zyra e Kryeministrit /Ured Premijera/Office Of The Prime Minister		
B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES' Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik		
Titulli i kontratës: Furnizim me pajisje të teknologjisë informative.		
Nr. i Prokurimit:	ZK104-25-858-5-5-8	
Nr. i Brendshëm:		
Radhë	Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Çmimi total i ofertës (me TVSH)
1.	Grup i Operatorëve Ekonomik STORM ICT L.L.C.; Safebit L.L.C., RR. Tahir Zajmi p/n. 10000, PRISHTINË	€ 78,948.54
2.	InterAdria L.L.C., ALI KELMENDI NR.28. - PRISHTINË	€ 79,844.00
3.	Grup i Operatorëve Ekonomik EGS; Pattern SH.P.K., Prishtine, 10000, Qendra Tregtare	€ 72,767.62
4.	Grup i Operatorëve Ekonomik ZZ ICT Solutions L.L.C.; P.C. COMP Sh.p.k.; Ndërmarrja Tregtare Grafike Blendi D.P., Rruga B, C 15/12, 10000, Prishtinë	€ 83,845.00
5.	ARITECH, PRISHTINË - LIPJAN KM.10- PËRBALLË QMI- SË 10500, GRACANICA	€ 78,453.00
6.	" INFINITT " SH.P.K., Dëshmorët e Kombit 10000, PRISHTINË	€ 86,490.00
Rezultati i aktivitetit të prokurimit: Zyra e Kryeministrit shpërblen me kontratë: Grup i Operatorëve Ekonomik EGS; Pattern SH.P.K., Prishtine, 10000, Qendra Tregtare		
Emri dhe mbiemri i ZPP:	Nënshkrimi:	Data:
Isa Hajdari		10.03.2025

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

N/A

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - ARITECH

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

Sqarim hyrës: Autoriteti kontraktues (AK) Zyra e Kryeministrit, ka zbatuar procedurë Mini-tender, sipas Kontratës Publike Kornizë me nr. të Ref.UA/2016 24 3927 111, me vlerë të parashikuar të kontratës € 87,000.00.

Parashtruesi i ankesës – ARITECH SHPK Graçanicë (më tej OE ankues) ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së me datë 14.03.2025, përderisa AK me datë 18.03.2025 ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

Pretendimi ankimor 1 OE ankues pretendon se AK ka shkelur kriteret teknike duke shpërblyer OE EGS & Pattern Shpk, ndonëse kjo e fundit ka ofertuar një procesor Intel Core Ultra 7 155H, i cili nuk është i gjeneratës së fundit siç kërkohej. Sipas OE ankues, gjenerata e fundit është Intel Core Ultra 7 258V, dhe vendimi bie ndesh me parimet e barazisë dhe transparencës në prokurimin publik.

Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor 1

Në Kontratën Publike Kornizë UA/2016 24 3927 111 / C549 – C568 në lidhje me gjeneratën e procesorit specifikohet: “Ne Aneksin 1. Tek specifikat teknike, tek "Procesori", është cekur që gjenerata duhet të jete minimum e parafundit në ditën e publikimit të njoftimit për kontratë, kjo do të

vlej edhe gjate procedurave te mini-tendereve ku ne secilin rast duhet te jete minimum gjenerata e parafundit ne ditën e "Ftesës për ofertim" (gjenerata do te vlerësohet ne baze te asaj te cilën e deklarone zyrtarisht secili prodhues se cila është gjenerata e fundit e tij).”.

AK në ftesën për ofertim tek pozicioni 4- Brand Name Laptop x 360 - Model III, ka përcaktuar specifikimin si vijon: “Procesori: Min. 8 cores, up to 3.4 GHz, min. 24 MB cache gjenerata e fundit dhe mbështetja për DDR5/LPDDR5”. Në titullin e pozicionit AK ka përcaktuar modelin (x360) që korresponon me modelin e prodhuesit HP x360, e i cili është ofertuar nga OE i rekomanduar për kontratë.

OE i rekomanduar, ne ofertën e tij lidhur me pozicionin 4 ka dorëzuar broshurën për produktin HP ENVY x360 15.6 inch 2-in-1 ku specifikohet procesori Processor: Intel® Core™ Ultra 7 Processor 155H 24M Cache, up to 4.80 GH”.

Mendimi i ekspertit teknik/shqyrtues Sipas sqarimit të mësipërm, specifikimi i procesorit të ofertuar është konform kërkesave. Ndërsa në lidhje me gjeneratën është evidente që në momentin e publikimit të ftesës për ofertim në treg ofrohen pajisje me gjeneratën Lunar Lake intel® Core™ Ultra 7 258V. Megjithatë në kontratën bazë specifikohet se gjenerata do te vlerësohet ne baze te asaj te cilën e deklarone zyrtarisht secili prodhues se cila është gjenerata e fundit e tij. Rrjedhimisht AK duhet të kërkoj sqarime nga OE i rekomanduar që të ofrojë dëshmi nga prodhuesi se cila është gjenerata e fundit në momentin e publikimit të Ftesës për ofertim.

Pretendimi ankimor 2 OE ankues pretendon se AK ka shkelur Nenin 61 të LPP-së duke mos verifikuar ofertën me çmim jonormalisht të ulët të GOE EGS & Pattern Shpk për pozicionin 5 (925 euro), që nuk mbulon as koston e kartelës grafike të kërkuar (NVIDIA RTX 4500 ADA 24GB GDDR6).

Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor 2 OE i rekomanduar për pozicionin 5 ka ofertuar me modelin e pajisjes Lenovo ThinkStation P3 Tower me çmimin për njësi prej 925.00 €. Për të njëjtin pozicion, çmimi për njësi nga tenderuesit në këtë procedurë është si vijon: Infinit-3,978.00 €, STORM ICT L.L.C & SAFE BIT-4,039.95 €, Interadria-4,099.00 €, Aritech-4,473.00 €, ZZ ICT

Solutions LLC; PC Comp-4,698.00 €. Nëse krahasohen ofertat e OE tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, atëherë plotësohen kushtet e përcaktuar në nenin 41.3 të Rregullores për Prokurimin Publik për tu konsideruar si çmim jo-normalisht i ulët.

Për më tepër, nëse analizohet specifikimi i ofruar, ku OE i rekomanduar në katalogun e kompjuterit (ThinkStation P3 Tower) ka nënvizuar (ofertuar) kartelën grafike Nvidia RTX 4500, e njëjta në një dyqan online të teknologjisë (Gjirafa 50) ka çmimin me zbritje prej 2,589.50 €. <https://gjirafa50.com/kartele-grafike-pny-rtx-4500-ada-generation-24gb-gddr6>.

Mendimi i ekspertit teknik /shqyrtues Sipas sqarimeve të mësipërme dhe bazuar në dallimin ekstrem të çmimit, konsiderohet se oferta e OE të rekomanduar përmbush kushtet për t’u klasifikuar si ofertë me çmim jo-normalisht të ulët, në përputhje me nenin 41.3 të Rregullores për Prokurimin Publik. Prandaj, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkojë një sqarim të detajuar financiar dhe teknik nga OE i rekomanduar. Nëse operatori ekonomik nuk arrin të justifikojë çmimin dhe përmbajtjen e ofertës në mënyrë të arsyeshme, bindëse dhe të verifikueshme, atëherë kjo ofertë duhet të refuzohet si jo e qëndrueshme ekonomisht dhe jo në përputhje me kërkesat reale të tenderit.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “ARITECH”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pajisje të teknologjisë informative” me numër të prokurimit: “ZK104-25-858-5-5-8, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – ZYRA E KRYEMINISTRIT

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **ZYRA E KRYEMINISTRIT**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **ARITECH**



Majlinda Bedrolli

Kreshnik Spahiu